



Instituti për
Kontabilitet
Auditim
Financa



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"

INSTITUTI KAF			INSTITUTI PËR KONTABILITET, AUDITIM DHE FINANCA INSTITUT ZA KNJIGOVODSTVO, REVIZIJU I FINANSIJE INSTITUTE FOR ACCOUNTANCY, AUDIT AND FINANCES		
Pranuar/Derëzuar Prilidjen/Predato Received/Delivered		Nr Prot Br. Prot Prot.No. 67			
Organizuesia Org./Jednica Org./Unit	Shtojca/Paqe Prillog./Strana Append./Page	Data Datum Date			
03	1/4	02.02.2017			
PRISHTINE/A					

MARËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur më: 02/02/2017 ndërmjet:

UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY OF GJILAN			
02.02.2017			
01	120		

- Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF) - Shoqatë Profesionale e licensuar për Certifikimin e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës, të cilën e përfaqëson Bujar Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv dhe
- Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Fakulteti Ekonomik, të cilën e përfaqëson Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është bashkëpunimi profesional për përgatitjen e kuadrove të reja në fushën e kontabilitetit dhe financave, shkëmbimin e përvojave në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe financave, si dhe certifikimin e studentëve të diplomuar të Fakultetit Ekonomik.

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

I. Fushëveprimi i bashkëpunimit

- Avancimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit duke u bazuar në SNK - Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, SNRF - Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe SNA - Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit;
- Thellohet njohja e standardeve ndërkombëtare të edukimit IES;
- Zbatohen standardet e lartpërmendura nëpërmjet inkorporimit të tyre në programet studimore;
- Përcaktohen procedurat për njohjen e programeve të caktuara studimore dhe certifikimeve profesionale;
- Krijohet një bazë e përgjithshme për arritjen e marrëveshjeve të veçanta të bashkëpunimit.

II. Format e bashkëpunimit

Për të arritur qëllimin, palët do të:

- (a) Bëjnë shkëmbimin ndërinstitucional të kuadrove duke ftuar stafin e institucionit partner të merr pjesë në aktivitete të ndryshme hulumtuese dhe zhvillime profesionale me qëllim përforcimi të programeve studimore konform standardeve ndërkombëtare; dhe
- (b) Shkëmbejnë informacione lidhur me zhvillimin e programeve studimore në të dy institucionet, duke u bazuar në direktiven numer 8 të BE-së për personat fizik të cilët mund të realizojnë auditimin e pasqyrave financiare dhe SNE 2 (Standardi Ndërkombëtar i Edukimit për përmbajtjen e kurikulës për zhvillimin profesional të kontabilistëve dhe auditorëve) i dalur nga bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet (IAESB).
- (c) Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe certifikimeve brenda universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan dhe perqatitje të studentëve për tregun e punës, konform objektivave të caktuara;
- (d) Shfrytëzojnë kapacitetet fizike dhe humane konform objektivave të caktuara;
- (e) IKAF dhe Universiteti "Kadri Zeka" përmes programit të bursave meritore do të mundësojnë përkrahje financiare për studentët e Universiteti "Kadri Zeka", që do të regjistrohen në certifikimet në IKAF, nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta;
- (f) Bashkëpunojnë në drejtim të krijimit dhe zhvillimit të një qendre për aftësim dhe arsimim profesional, me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për qasje të individëve të caktuar në tregun e punës.

III. Njohja e programeve të caktuara studimore dhe certifikimeve profesionale

IKAF përcakton procedurat për njohjen e programeve të caktuara studimore të këtij bashkëpunimi për studentët e Fakultetit të Ekonomik të UKZ si më poshtë:

- (a) Të diplomuarit në drejtimet ekonomike, do të kenë mundësi t'i nënshtrohen procesit të njohjes së provimeve të caktuara bazuar në trajtimin e planprogramit dhe procedurave të përcaktuara të njohjes nga IKAF.
- (b) Shqyrtimi i dokumentacionit për njohje do të bëhet në mënyrë konfidenciale bazuar në pajtueshmërinë e dyanshme të palëve;
- (c) Shqyrtimi i njohjeve do të bëhet në bashkërendim me zhvillimin e procesit të integritetit të standardeve ndërkombëtare në programet studimore të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

Po ashtu, Universiteti "Kadri Zeka" mbanë të drejtën e plotë për t'i përcaktuar procedurat për njohjen e certifikimeve profesionale të caktuara në pikën III të këtij bashkëpunimi për studentët e IKAF-it.

IV. Zbatimi

Palët duhet të emërojnë nga një koordinator për zbatimin e drejtëpërdrejtë të këtij bashkëpunimi. Koordinatorët, duke punuar me administratorët tjerë përkatës të institucioneve në fjalë, do të kenë përgjegjësitë si në vijim:

- (a) Të promovojnë bashkëpunimin akademik dhe profesional ndërmjet dy institucioneve për zbatimin e këtij Bashkëpunimi bashkëpunimi;
- (b) Të veprojnë si persona kontaktues për aktivitetet individuale dhe grupore, dhe të planifikojnë koordinimin e të gjitha aktiviteteve brenda institucioneve të tyre; dhe
- (c) Të takohen në bazë periodike për të rishikuar dhe vlerësuar aktivitetet e kaluara.

V. Publikimet dhe pronësia intelektuale

Të gjitha publikimet që dalin nga bashkëpunimi në mes të këtyre dy institucioneve duhet të bazohen në këtë marrëveshje.

Prezantimet formale që rezultojnë nga bashkëpunimi i përcaktuar duhet referuar bashkëpunimit.

Në materialet e publikuara dhe prezantimet e ndryshme si rezultat i këtij bashkëpunimi duhet të përdoret logo e të dyja institucioneve.

Nëse nga ndonjë bashkëpunim reciprok rezulton ndonjë çështje që ka të bëjë me potencialin për të drejten autoriale, palët duhet të takohen menjëherë dhe të shkëmbejnë mendimet lidhur me pronësinë në fjalë dhe interesat tjera pronësore që mund të rrjedhin nga ky bashkëpunim. Nëse autorësia është e lidhur me krijuesin e caktuar, atëherë ajo i takon atij.

VI. Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë për ndryshimet dhe plotësimet e tij si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si:

- a) Ndryshimet ose plotësimet e marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre.
- b) Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë program të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

VII. Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje lidhet me kohë të pacaktuar. Kohëzgjatja e zbatimit të bashkëpunimit do të përcaktohet në bazë të fondeve në dispozicion për të dy institucionet si dhe në bazë të asistencës financiare që mund të realizohet nga burimet e jashtme.

Përfundimi i këtij bashkëpunimi mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundoj njëanshëm nga njëra palë me paralajmërim prej së paku tre muajsh.

Marrëveshjet gojore për çështje të caktuara, gjithashtu nuk gjejnë mbështetje në këtë Marrëveshje dhe ato nuk do të merren parasysh.

VIII. Ligji i aplikueshëm

Palët respektojnë dhe zbatojnë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, rregullat dhe kërkesat tjera të aplikueshme të autoriteteve përkatëse shtetërore.

IX. Mospajtimet


Të gjitha mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.

X. Hyrja në fuqi

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit. Bashkëpunimi nënshkruhet në dy kopje, për secilën palë nga një.


Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 02/02/2017

Universiteti "Kadri Zeka"


Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi,
Rektor



Instituti IKAF


Bujar Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv

